



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:282290
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07036277

AA.nr.491/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, paditëses, H.H, Komuna e Malishevës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, I.I nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale, me seli në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1965/2019, të datës 21.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1965/2019, i datës 21.03.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1965/2019, të datës 21.03.2024, është vendosur, “**I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses H.H, Komuna e Malishevës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.I nr.34. **II. ANULOHET** vendimi me nr. të dosjes 5054526 i datës 10.05.2019 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve dhe paditëses H.H, Komuna e Malishevës i njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme nga data 15.09.2014 e deri me datën 15.06.2022, kur e paditura ja ka njohur të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme. **III. OBLIGOHET** e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve që paditëses t’ia bëjë pagesën/kompensimin e pensionit të pa aftësisë së përhershme në mënyrë retroaktive nga data 15.09.2014 e deri me datën 15.06.2022, në shumë të përgjithshme prej 7,675.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. **IV. Ky aktgjykim e zëvendëson** vendimin me nr. të dosjes 5054526 i datës 10.05.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve. **V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale, me seli në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale, të prishet aktgjykimi i goditur me këtë ankesë dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.5054526 i datës 10.05.2019, i të paditurës.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësja.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të paditurës dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë 19.08.2019, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale, me seli në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa bazuar dhe të kundërligjshëm, me propozim që të aprovohet padia e paditësës dhe gjykata vetë të miratojë kërkesën e paditësës për njohjen e të drejtës si përfitues i pensionit të personave me paafësi të përhershme.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësës si të bazuar, me arsyetim se “Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 09.01.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor nenit 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurës-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore e cila me parashtresën e datës 04.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe i ka propozuar gjykatës që veprohet konform nenit 38 par.5 të LKA-së. Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 21.03.2024, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimin e MPMS-së të dt.10.05.2019, Aktgjykimin e kësaj gjykate A.nr. 1794/2015 të dt.16.10.2018, Vendimin e MPMS- të dt.15.12.2014, Raportet mjekësore dhe fletë lëshimet spitalore për paditësen të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Vendimin e MPMS-së për paditësen të dt. 30.09.2014, Ankesën e paditëse të dt.18.11.2011, Vendimin e MPMS-DP të dt.23.09.2011, Vendimin e MPMS-DP të dt.24.02.2006, Formularët e vlerësimit të komisionit mjekësor të paditurës për paditësen, Certifikatat e mjekut për personat me pa aftësi të kufizuar për paditësen, Fotografitë e paditëses, Ekspertizën mjekësore për paditësen të datës 30.10.2023, Procesverbalin e seancës të datës 04.03.2024, Ekspertizën financiare të datës 15.02.2024 të ekspertes Emine Avdullahu së bashku me shtojcën e bashkangjitur. Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësës është e bazuar, për këto arsye: Gjykata fillimisht konstaton se në këtë konflikt administrativ padia nga ana e paditësës Lindita Shala, është ushtruar ndaj të paditurës Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, për shkak se e njëjta e kishte nxjerr vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 5054526 të datës 10.05.2019, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.03.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditësës

ka bërë ndryshimin dhe rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv, ku në vend të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve ka deklaruar se si palë e paditur në këtë konflikt administrativ duhet të jetë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për shkak të ndryshimit të emërtimit të paditurës. Gjykata me aktvendim të marr në seancë konform dispozitave të nenit 258 të LPK-së, dispozita këto të zbatueshme në procedurën e konfliktit administrativ sipas nenit 63 të LKA-së, ka lejuar ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, për arsye se, me votimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 22.03.2021 nga ana e Kuvendit të Kosovës Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale është shkruar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe të gjitha përgjegjësitë sa i përket kategorive sociale dhe pensioneve kanë kaluar në kompetencë të kësaj ministrie. Nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjykata ka konstatuar që e paditura duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1794/2015 të datës 16.10.2018, me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 5054526 i datës 10.05.2019 i ka refuzuar paditëses ankesën, për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme. E paditura në vendimin e kontestuar ka theksuar se DP duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1794/2015 të datës 16.10.2018, në lidhje me padinë e H.H, gjegjësisht komisioni mjekësor me ekspert të lëmive përkatëse, në seancën e datës 26.04.2019 në mënyrë të gjithanshme, përsëri ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor dhe vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë, në përputhje me nenin 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe ka konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me pa aftësi të përhershme, prandaj komisioni mjekësor i caktuar enkas në ri procedurë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë që nuk janë plotësuar kriteret për PAK dhe konform kësaj ankesën e refuzon si të pa bazuar. Gjykata nga shkresat e lëndës, e ka konstatuar faktin se ish e paditura Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (Tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve), përmes vendimin të datës 24.02.2006 i ka njohur paditëses të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme prej datës 01.01.2004, në shumë mujore prej 40€, për periudhë pesë vjeçare, e drejt kjo e cila sërish i ishte njohur paditëses në ri vlerësim nga data 01.09.2011, për periudhë tri vjeçare, kurse i është ndërprerë me vendimin e datës 30.09.2014, pas ri vlerësimi. Sërish nga data 15.06.2022 e paditura rezulton se ja ka njohur paditësen të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme. Me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të saktë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, respektivisht mbi gjendjen shëndetësore të paditëses, gjykata në seancën gjyqësore të datës 20.03.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, duke e caktuar që këtë ekspertizë ta bëjë Qendra Klinike Universitare në Prishtinë, ku të njëjtën e ka detyruar që të caktoj një komision mjekësor prej tre mjekëve specialist përkatës. QKUK nuk kishte arritur ta kryente ekspertizën mjekësore andaj gjykata me aktvendimin e datës 05.09.2023 e kishte revokuar aktvendimet e datës 20.03.2023, vetëm sa i përket pjesës ku është obliguar QKUK që të caktoj një komision mjekësor në përbërje prej tre mjekësve specialist për ta kryer ekspertizën mjekësore dhe në pikën II të këtij vendimi ka caktuar ekspertët mjekësore Dr.Adnan Biqku-neurolog, Dr.Isuf Zekaj-kirurg i përgjithshëm dhe Dr.Violeta Hyseni-Kardiologe, për ta kryer ekspertizën mjekësore, respektivisht për ta nxjerr mendimin dhe konstatimin profesional nëse tek paditësja ekziston pa aftësia e përhershme për punë. Mjekët specialist të caktuar nga gjykata në ekspertizën mjekësore të datës 30.10.2023, pas analizimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses kanë dhënë mendimin profesional se pacientja/paditësja vuan nga këto sëmundje: Status post comisurtomia valvulae mitralis, restenosis valvulae mitralis, regurgitatio valvulae mitralis gravis, FA chronica, Portatore proteze mekanike në pozicion mitral, CMP chr valavularis sec.dilatativa insuff.cordis NYHA II, status post ICV ischamica, hemiparesis spastica lateralis dexter, e ku si pasoj e këtyre sëmundjeve pacientja ka pa aftësi të përhershme për punë dhe jetë të pavarur. Ekspertja mjekësore Dr.Violeta Hyseni-Kardiologe në seancën e shqyrtimit gjyqësor

të datës 04.03.2020 ka deklaruar se mbetem pran ekspertizës mjekësore e cila i është dorëzuar gjykatës e datës 30.10.2023 dhe jam e hapur për pyetje eventuale. Ajo është përgjigjur në pyetjet e gjykatës se paditësja nga shkresat lendes rezulton se ka pasur probleme me valvula mitrale para vitit 2014, ku për shkak, problemeve të cilat i ka pasur është dashur të bëhej ndërhyrje dhe të zëvendësohen valvulet mitrale. Sipas ekspertës edhe para vitit 2022, respektivisht pas vitit 2014, gjendja shëndetësore e paditëses nuk ka qenë e permisuar në mënyrë që ajo të jete e aftë për punë, për shkak të diagnozave të cilat paditësja i ka pasur. Ekspertja po ashtu ka deklaruar se valvula mitrale paditëses i është implantu në vitin 2016 (protezë mekanike), kurse para ndërhyrjes paditësja ka pasur probleme në regurgitim mitral dhe stenoze të valvules mitrale, ndërsa si rezultat i këtyre diagnozave është realizuar implantimi i valvules mitrale. Për të llogaritur shumën e cila do ti takonte paditëses në emër të pensionit për pa aftësi të përhershme nga data 15.09.2014, kur paditëses i është bërë rivlerësimi nga ana e Komisionit Mjekësor të paditurës e deri në datën e nxjerrjes së ekspertizës, duke marr parasysh ndryshimet në vlerën e këtij pensioni përgjatë kësaj periudhe kohore, gjykata me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.02.2024, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ duke caktuar ekspertin financiar Emine Abdullahu që ta kryej ekspertizën. Ekspertja financiare në ekspertizën financiare të datës 15.02.2024, në bazë të dokumentacionit shkresor dhe sqarimeve të pranuar nga e paditura, ka dhënë mendimin dhe konstatimin profesional se shuma e pensionit për personat me pa aftësi të përhershme për periudhën nga data 15.09.2014 e deri me datë 14.06.2022 është 7,675.00€. Kjo pasi që paditësja nga data 15.06.2022 ka status aktiv në MPMS-DP dhe vazhdon të pranoj pension për kategorinë e PPAK. Ekspertja financiare në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.03.2024 ka deklaruar mbetem në tërësi siç kam dhënë edhe mendimin në ekspertizën financiare të dt.15.02.2024. Ka cekur se në ekspertizë është përfshirë llogaritja e pensionit të pa aftësisë së përhershme e cila kishte mi takuar paditëses nga data 15.09.2014, siç na ka obliguar gjykata me aktvendim, mirëpo kjo përllogaritje është bërë deri me datën e aplikimit të këtij pensioni 15.06.2022, ku nga të gjeturat kemi konstatuar se pala paditëse ka status aktiv pra e merr këtë pension nga data 15.06.2022, prandaj kjo periudhë nuk është përfshirë në ekspertizë. I gjithë kalkulimi është bazuar në bazë dhënat e siguruar nga ministria. Ka theksuar se në ekspertizë janë përfshirë edhe ndryshimet e ndodhura sa i përket vlerës së pensionit të aplikuar, si dhe shtesat të cilat janë ndarë këtyre kategorive me vendime qeveritare, e ku vlera totale me të gjitha llogaritjet është 7,675.00€. Në nenin 3 par.1 pika 1.6 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti është paraparë “1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.6. Pensioni i pa aftësisë të përhershme - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”. Në vazhdim në nenin 9 të këtij ligji përcaktohet “1. Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.2. Pensioni i paaftësisë së përhershme do t’iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç. 3. Kërkesa për pension të paaftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitet të Kosovës.4. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, ne Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale.5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: 5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore;5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; 5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet

procedurës së rivlerësimit mjekësor. 6 Ministria apo Autoriteti përkatës mund t'i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar. 7. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përhershme duhet të përmbajnë rregulla të përcaktuara me qëllim të mbrojtjes së informatave mjekësore konfidenciale të aplikuesve të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore". Në nenin 5 par.1 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme përcaktohet se "E drejta për të aplikuar për pension të pa aftësisë së përhershme, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit përkatësisht formularit për aplikim në pension i cili duhet të përmbajë: 1.1 emërtimin e organit të cilit i drejtohet; 1.2 emrin e kërkuetit; 1.3 arsyen për njohjen e të së drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme; 1.4 datën e dorëzimit dhe 1.5 nënshkrimin". Në paragrafin 2 të nenit 5 të këtij UA parashihet që "Kërkesës, duhet bashkëngjiten edhe këto dokumente si në vijim: 2.1 Dëshminë mjekësore se është me pa aftësi të përhershme; 2.2 Certifikatë apo raport mjekësor të lëshuar nga institucionet shëndetësore të nivelit sekondarë apo terciar. Në certifikatë duhet të jetë specifikuar vlerësimi i aftësisë së kufizuar, 2.3 Kopjen e dokumentit të identifikimit; 2.4 Ekstraktin nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar; 2.5. Ekstraktin e lindjes; Një nga dëshmitë për faturat të cilat janë në emër të vet, faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit, mbeturinave, 2.7 Dëshmi tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse". Në nenin 8 par.1, 2 dhe 3 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme thuhet se "1. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Mjekësor i Departamentit të Pensioneve. 2. Komisioni Mjekësor, shqyrtimin e lëndës dhe ekzaminimet mjekësore i kryen në zyrat pensionale përkatëse. 3. Komisioni Mjekësor, në bazë të dëshmimeve mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se e ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës". Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar në ligj dhe fakte. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ siç janë; raportet mjekësore të paditëses të paraqitura si prova në procedurë administrative tek e paditura dhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, vendimi i MPMS-DP-së i 24.02.2006, i cili ka njohur paditëses të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme prej datës 01.01.2004, për periudhë pesë vjeçare, e drejt kjo e cila sërish i ishte njohur paditëses në ri vlerësim përsëri nga data 01.09.2011, për periudhë tri vjeçare, kurse i është ndërprerë me vendimin e datës 30.09.2014, pas ri vlerësimit, e më pastaj sërish nga data 15.06.2022 i është njohur paditëses e drejtë në pension të pa aftësisë së përhershme nga e paditura, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 30.10.2023, ekspertëve specialist mjekësor gjyqësor Dr. Adnan Biqku-neurolog, Dr. Isuf Zekaj-kirurg i përgjithshëm dhe Dr. Violeta Hyseni-Kardiologe, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi, sepse e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ, gjykata erdh në përfundim se paditësja i plotëson kushtet ligjore nga neni 9 par.5 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe neni 5 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, për të qenë përfitues i pensionit të pa aftësisë së përhershme për periudhën data 15.09.2014, kur komisioni mjekësor i të paditurës në ri vlerësim i kishte ndërprerë paditëses të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme e deri me datën 15.06.2022, kur e paditura përsëri i ka njohur paditëses të drejtën në pension të paaftësisë së përhershme. Gjykata nga shkresat e lëndës konstaton në rastin konkret edhe pse ishte anuluar vendimi i MPMS-DAPRK-së me nr. të dosjes 5054526 i datës 15.12.2014 dhe çështja ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1794/2015 të datës 16.10.2018, organi i paditur me rastin

e vendosjes në ri procedurë, nuk i ka përfillur vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën dhe pikëpamjet juridike të gjykatës lidhur me vendimin e nxjerr nga e paditura në procedurë administrative. Në këtë drejtim gjykata thekson se e paditura në vendimin e kontestuar e ka përmendur faktin se komisioni mjekësor me ekspert të lëmive përkatëse në seancën e dt.26.04.2019, në mënyrë të gjithanshme përsëri ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor dhe vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë, mirëpo nga kjo kuptohet se e paditura-komisioni mjekësor i saj në ri procedurë nuk e ka bërë ekzaminimin e paditëses, për të ardhur deri tek konkluzioni i drejt i gjendjes faktike, ashtu siç parashihet me nenin 8 par.3 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme. E paditura në ri procedurë ka dështuar që të jap sqarime se nga cila bazë paditëses i ishte ri kthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur me aktvendimin e datës 15.09.2014, i ka refuzuar paditëses kërkesën për pension. Gjykata thekson se Komisioni Mjekësor i të paditurës në shkallë të parë me datë 15.09.2014, por edhe në shkallë të dytë me datë 27.11.2014, sikurse edhe në ri procedurë me datë 26.04.2019, nuk ka dhënë vlerësimin se a ekziston ose jo pa aftësia e përhershme e paditëses, por në formular të vlerësimin e kanë shënuar fjalën refuzim dhe duke përzgjedhur opsionin refuzim, mirëpo një veprim i tillë i Komisionit Mjekësor, së bashku me formularin e vlerësimin, janë në kundërshtim me nenin 8 par.3 dhe 4 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme ku parashihet se “3. Komisioni Mjekësor, në bazë dëshmime mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se ekziston apo nuk ekziston pa aftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës. 4. Komisioni Mjekësor, pas shqyrtimit dhe vlerësimin të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, e kthen tek organi i shkallës së parë për marrjen e vendimit”. Kështu që gjykata vlerëson se nuk ka qenë kompetencë e komisionit mjekësor të paditurës të vendos në lidhje me kërkesën e paditësit për njohjen ose refuzimin e kërkesës për pension të pa aftësisë së përhershme, por komisioni mjekësor ka pasur për detyrë vetëm ta vlerësojë se a ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek paditësi. Në rrethanat e tilla faktike gjykata vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me pa aftësi të përhershme, nuk është bazuar dhe i drejt, për shkak se, në rastin konkret nga ana e të paditurës nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi, përkitazi me kushtet ligjore për njohjen/vazhdimin e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme. Kjo, për shkak se sipas vlerësimin të gjykatës, e paditura me rastin e ri vlerësimin të kryer për paditësen me datë 15.09.2014, atë me datë 27.11.2014, sikurse edhe në vlerësimin në ri procedurë me datë 26.04.2019, sipas vendimit të gjykatës përmes komisionit mjekësor, nuk ka arritur të konstatojë një gjendje tjetër faktike nga ajo e mëparshme. Gjykata konstaton se nga ekspertiza mjekësore e mjekëve specialist e datës 30.10.2023, është vërtetuar se paditësja vuan sëmundjet e tilla siç janë: “status post comisurtomia valvulae mitralis, restenosis valvulae mitralis, regurgitatio valvulae mitralis gravis, FA chronica, Portatore proteze mekanike në pozicion mitral, CMP chr valavularis sec.dilatativa insuff.cordis NYHA II, status post ICV ischamica, hemiparesis spastica lateralis dexter”, e ku si pasoj e këtyre sëmundjeve e njëjta ka pa aftësi të përhershme për punë dhe jetë të pavarur dhe se kjo pa aftësi ka ekzistuar edhe para vitit 2022, respektivisht pas vitit 2014, pasi që gjendja shëndetësore e paditëses nuk ka qenë e permisuar në mënyrë që ajo të jete e aftë për punë, për shkak të diagnozave të cilat paditësja i ka pasur. Gjykata thekson se e paditura në parashtrësën e datës 04.03.2024 e ka kundërshtuar ekspertizën mjekësore, mirëpo gjykata vlerëson se ato kundërshtim janë të pa bazuara. Kjo për faktin se ekspertiza mjekësore është nxjerr si provë në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 356 i LPK-së, me mjekë specialist përkatës mjekësor të licensuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilët ekspertizën e kanë kryer në mënyrë profesionale, në pajtim me rregullat e etikës profesionale, duke i pasur parasysh shkresat e lëndës, gjegjësisht dokumentacionin mjekësor të paditëses dhe ekzaminimin e saj.

Bazuar në dokumentacionin mjekësor i cili ka qenë në shkresat e lëndës, dokumentacion ky i cili e ka përfshirë edhe periudhën nga viti 2014, por edhe para dhe pas kësaj periudhe, mjekët specialist kanë nxjerr mendimin profesional se paditësja edhe gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë e pa aftë për punë, për shkak të diagnozave të cilat i ka pasur. Kështu që gjykata konstaton se e paditura përveç kundërshtimeve të ekspertizës nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër mjekësore e cila do të ndryshonte në mendimin dhe konstatimin profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor të caktuar nga gjykata. Nga një gjendje e tillë e çështjes gjykata vlerëson se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se i njëjta i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë përfituese i pensionit të pa aftësisë të përhershme, sipas nenit 9 par.5 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe nenit 5 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme për periudhën data 15.09.2014 e deri me datën 15.06.2022. Prandaj gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore nga neni 46 par.4 dhe 5 të LKA-së, dispozitën e nenit 20 par.1 të Ligjit nr.04/L-131 ku parashihet se “1. Të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës”, dhe precizimin e kërkesëpadisë së paditësit të bërë nga i autorizuari i paditëses, vendosi që në dispozitivin e parë të aktgjykimit ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, në dispozitivin e dytë të aktgjykimit e anuloi vendimin me nr. të dosjes 5054526 i datës 10.05.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve dhe paditëses i njohu të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme nga data 15.09.2014, kur komisioni mjekësor i të paditurës në ri vlerësim i kishte ndërprerë paditëses të drejtën në pension të pa aftësisë së përhershme e deri me datën 15.06.2022, kur e paditura në ri vlerësim i ka njohur përsëri paditëses këtë të drejtë, duke e obliguar të paditurën që paditëses t’ia paguaj në mënyrë retroaktive shumën e përgjithshme prej 7,675.00€, sipas kalkulimit të ekspertizës financiare. Gjkata edhe ekspertizës financiare të ekspertes Emine Abdullahu të datës 15.02.2024 ja fali besimin në tërësi sa i përket shumës së kalkuluar në emër pensionit të pa aftësisë së përhershme për paditësin, për arsye se, edhe kjo ekspertizë ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat e caktuara nga gjykata dhe se konstatimet e dhëna në të nuk ishin kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPPA-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar

është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e nxjerrë nga Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditëses të datës;30.10.2023, e cila është përgatitur nga mjekë specialist, Dr. Adnan Biqku-neurolog, Dr. Isuf Zekaj-Kirurg i Përgjithshëm, dhe Dr. Violeta Hyseni-Kardiologe, të cilët pas ekzaminimit të paditëses dhe sqarimeve të dhëna në seancë, të njëjtit kanë nxjerrë mendim-përfundim se *“pacientja-paditësja vuan nga këto sëmundje: Status post comisurtomia valvulae mitralis, restenosis valvulae mitralis, regurgitatio valvulae mitralis gravis, FA chronica, Portatore proteze mekanike në pozicion mitral, CMP chr valavularis sec.dilatativa insuff.cordis NYHA II, status post ICV ischamica, hemiparesis spastica lateralis dexter, e ku si pasoj e këtyre sëmundjeve pacientja ka pa aftësi të përhershme për punë dhe jetë të pavarur.”* Kurse ekspertizën nuk e ka kundërshtuar as paditësja, e as e paditura, pas dorëzimit të saj me dt.04.11.2023, e as në seancën e dt.21.03.2024, në të cilën është thirrur e paditura në mënyrë të rregullt dhe nuk ka marrë pjesë. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë së aprovuar drejtë është vendosur duke u bazuar në ekspertizën e nxjerrë me propozim të autorizuarit të paditëses të përgatitur nga ekspertja financiare, Emine Abdullahu, të datës 15.02.2024, e të cilën ekspertizë e ka kundërshtuar e paditura, mirëpo nuk ka bërë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re për ti rrezuar eventualisht përfundimet e nxjerrë nga kjo ekspertizë. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë edhe në drejtim të lartësisë së kërkesëpadisë së aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoj, për faktin se ekspertiza mjekësore dhe financiare janë të qarta dhe nuk kanë kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të reja, të cilat eventualisht do ta vërtetonin të kundërtën nga ajo që është dhënë në ekspertizë. Prandaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit dhe se e njëjta drejtë ka zbatuar dispozitat Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht, nenin 9 të tij, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të kontestuar.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, në këtë kuptim ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.491/2024, datë 18.03.2025

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti